



## Përditësim

Mirë se vini në informimin javor të Dhomave të Specializuara të Kosovës, ku synojmë t'u ofrojmë gazetarëve informacion të përditësuar mbi zhvillimet e fundit në Gjykatë dhe mundësinë për të bërë pyetje.

Në gjykimin e Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Jakup Krasniqit dhe Rexhep Selimit, më 25 gusht, Trupi Gjykses miratoi pjesërisht kërkesën e Mbrojtjes së Veselit për të bërë publike disa pjesë të transkriptit të seancës së 27 marsit 2025, e cila u zhvillua në seancë private dhe që lidhet me një prokuror që ka punuar më parë në Njësinë e Paraburgimit të Gjykatës.

Gjykatësit konstatuan se disa prej pjesëve të transkriptit që kishin të bënin me aspekte të brendshme, operative dhe të ndjeshme nga pikëpamja e sigurisë së Njësisë së Paraburgimit duhet të mbeteshin konfidenciale, por vendosi që të bënte publike pjesët e tjera të transkriptit. Trupi Gjykses u pajtua me Mbrojtjen se këto pjesë të transkriptit nuk trajtojnë aspekte konfidenciale apo tema që janë objekt i masave mbrojtëse. Veç kësaj, Trupi Gjykses nuk mundi të evidentonte ndonjë interes publik relevant që do të përlligjte apo justifikonte redaktime të tjera të kësaj pjese të procesverbalit.

Gjykatësit në këtë çështje gjyqësore kanë krijuar një sistem në bazë të të cilit rishikojnë dhe bëjnë publike rregullisht materiale që kanë qenë më parë konfidenciale. Kjo bëhet për të siguruar që procesi gjyqësor të jetë sa më publik që të jetë e mundshme.

Në të njëjtën çështje gjyqësore, këtë javë u bë publik një vendim i majit 2025, në të cilin Trupi Gjykses kishte shqyrtuar kërkesën e Prokurorisë për të pranuar prova lidhur me përpjekjet e pretenduara për të ndikuar në mënyrë të paligjshme ndaj dëshmitarëve në këtë çështje.

Trupi Gjykses hodhi poshtë disa pjesë të kërkesës së Prokurorisë dhe pranoi pjesët e tjera.

Provat në fjalë lidhen me incizimet që janë bërë gjatë vizitave në objektin e paraburgimit në 2023 të cilat duket se tregojnë z. Thaçi duke u dhënë udhëzime të hollësishme disa prej vizitorëve të tij për mënyrën si duhet të ndikojnë në dëshmitë e dëshmitarëve në gjykimin e tij për krime lufte. Megjithëse këto pretendime janë objekt i një aktakuze të veçantë kundër z. Thaçi dhe katër të tjerëve për pengim drejtësie, pyetja në fjalë është nëse këto prova janë të pranueshme në gjykimin për krime lufte kundër zotërinjve Thaçi, Veseli, Selimi dhe Krasniqi.

Gjykatësit konstatuan se provat janë relevante dhe të pranueshme për të vlerësuar besueshmërinë e dëshmitarëve që kanë dhënë dëshmi në gjykim si dhe për të vlerësuar atmosferën e frikësimit të dëshmitarëve që lidhet me këtë gjykim. Në këtë Vendim, Trupi Gjykses po ashtu njoftoi se disa prej dëshmitarëve të Prokurorisë kanë refuzuar të japin dëshmi në sallën e gjyqit për arsye lidhur me sigurinë e tyre dhe të familjes.





Në të njëjtën kohë, gjykatësit rrëzuan kërkesën e Prokurorisë për të shqyrtuar prova lidhur me fajësinë e mundshme penale të z. Thaçi në çështjen për krime lufte apo për përcaktimin e dënimit në rast vendimi fajësie. Trupi Gjykues vendosi të mos i pranonte provat me qëllim që të garantonte të drejtën e z. Thaçi për gjykim të drejtë.

Trupi Gjykues rrëzoi gjithashtu kërkesën e Prokurorisë për të pranuar prova që përfshinin transkripte të Rexhep Selimit dhe Kadri Veselit nga objekti i paraburgimit ku duket se ata nxjerrin informacion konfidencial lidhur me dëshmitarë të mbrojtur, duke cituar të njëjtat arsye, dhe po ashtu rrëzoi kërkesën e Prokurorisë për të ndryshuar listën e provave materiale për shkak se nuk kishte paraqitur arsye bindëse si dhe për arsye se Kërkesa nuk u dorëzua në kohë.

Në çështjen gjyqësore *Hashim Thaçi, Bashkim Smakaj, Fadil Fazliu, Isni Kilaj dhe Hajredin Kuçi*, më 27 gusht, Gjykatësja e Procedurës Paraprake rrëzoi kërkesën, e Mbrojtjes së Kilajt për të marrë versionin e paredaktuar të një urdhri të mëparshëm për kontrollim dhe sekuestrim, dhe vendosi se do të lëshohet një version i dytë konfidencial me më pak redakte i Vendimit për Kontrollim dhe Sekuestrim që do t'u dorëzohet së shpejti të gjitha ekipeve të Mbrojtjes.

Në të njëjtën çështje gjyqësore, më 22 gusht 2025, Gjykatësja e Procedurës Paraprake vendosi që Shtojca e Kërkesës së Prokurores së Specializuar për Modifikimin e Kushteve të Paraburgimit të Hashim Thaçit duhet të mbetet konfidenciale për momentin.

Për kujtesë: më 18 gusht, Gjykatësja e Procedurës Paraprake miratoi pjesërisht kërkesën e Prokurorisë për të ndaluar 11 persona që të vizitojnë z. Thaçi në objektin e paraburgimit.

Në vendim, Gjykatësja shpjegonte se, vendimi për të ndaluar vizitat nga një grup i kufizuar personash ishte i domosdoshëm për të zvogëluar rrezikun e nxjerrjes së paligjshme të informacionit konfidencial lidhur me dëshmitarët e mbrojtur si dhe proporcional sepse lidhet vetëm me personat për të cilët ka, së paku, tregues të besueshëm për: (a) pjesëmarrje në vizita jo të privileguara në objektin e paraburgimit ku z. Thaçi ka nxjerrë informacion konfidencial lidhur me dëshmitarë (të mbrojtur) të ZPS-së; dhe (b) përfshirje ose dyshime për sjellje të papajtueshme me integritetin e procesit dhe/ose Rregulloren e Paraburgimit.

Vendimi nuk prek vizitorët e tjerë të mundshëm të z. Thaçi në objektin e paraburgimit. Veçanërisht, Gjykatësja e Procedurës Paraprake rrëzoi kërkesën e Prokurorisë për të ndaluar vizitat prej tre vëllezërve të z. Thaçi, duke kujtuar se në kushte paraburgimi është element thelbësor i respektimit të së drejtës së të paraburgosurit për jetë familjare që të kontaktojë të afërmit e ngushtë, ku përfshihen vëllezërit e motrat.

